



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 7 shkurt 2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Faton Topalli, Verica Çeraniq, Shqipe Pantina, Albert Kinolli, Andin Hoti, Ali Lajçi, Avdullah Hoti, Muharrem Nitaj, Mërgim Lushtaku dhe Zafir Berisha.

Munguan: ishin prezent të gjithë.

Stafi mbështetës i komisionit: Mehmet Simnica.

Pjesëmarrësit tjerë: Naim Bardiqi, Basri Sejdiu, Myzafer Kalanderi, Demë Rexhepi, Hajzer Dobra dhe Zenel Hisenaj, MSH; Vlora Spanca, Bujar Bajraktari, Myrvete Gashi, Florim Beqiri, Elvin Mala dhe Labinot Sadiku, ZKA; Qëndresë Mustafa, BIRN dhe Mentor Hyseni, GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 30.1.2018;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e SHSKUK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
5. Shqyrtimi i raportit të performancës për efikasitetin dhe efektivitetin në implementimin e Sistemit informativ unik të integruar shëndetësor;
6. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.1.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 30.1.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

Kryetari njoftoi deputetët se Ministri i Shëndetësisë, z. Uran Ismajli, për shkak të agjendës nuk do të jetë prezent në këtë takim, andaj pa prezencën e ministrit, nuk mund ta shqyrtojmë raportin.

Përfundim

KMFP vendosi që shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të bëhet në mbledhjen e radhës së komisionit.

4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e SHSKUK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

Kryetari njoftoi deputetët se për shqyrtimin e kësaj pike kemi prezent u.d. së drejtorit të SHSKUK-së, së bashku me ZKF-në. Po ashtu, raportuese për këtë raport kemi deputetin, z. Mërgim Lushtaku. Me këtë hapi diskutimin.

Mërgim Lushtaku, theksoi se opinion i pamodifikuar, me theksim të çështjes i është dhënë raportit të auditimit për PVF-të e SHSKUK-së, nga ana e auditorit për vitin 2016. Pasqyrat financiare, të gjeturat kryesore: shpenzimet në vlerë 1,078,578€ për mirëmbajtje dhe servisim të pajisjeve mjekësore ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Më tej, këto shpenzime janë regjistruar si pasuri në regjistrin kontabël, duke i mbivlerësuar pasuritë. Regjistri i pasurive kapitale nuk ishte i plotë edhe për shkak se pasuritë e blera me vlerë 210,960€ nuk ishin regjistruar. Këtu përfshihen pajisjet, në kuadër të kontratës “Furnizimi me aparat digjital Mammography System”, në vlerë 184,670€, “Sonde paradontale kompjuterike e automatizuar”, në vlerë 7,590€, si dhe “Renovimi i hapësirave të brendshme dhe furnizimi me ashensorë” në vlerë 18,700€. Pagesat në vlerë prej 1,089,064€ janë paguar nga SHSKUK, si pasojë e ndryshimit të kushteve të dy kontratave kornizë, e që nuk është në pajtim me rregullat e prokurimit publik. Pagesat në vlerë prej 604,117€ janë realizuar për sigurimin fizik të objekteve të QKUK-së, pasi ishte zgjatur afati i kontratës për 8 (tetë) muaj. Ndërsa, pagesat prej 484,946€ janë realizuar për projektin “Pastrimi i sipërfaqeve të brendshme të QKUK-së”, ku përfshihet ndryshimi i kushteve të kontratës për 11 muaj (rritja e pagesës mujore për 15,078€) dhe pagesat për 3 (tre) muajt, sa ishte zgjatur afati i kontratës. Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak, vetëm një pjesë e vogël e rekomandimeve të vitit

të kaluar është zbatuar, sepse menaxhmenti i SHSKUK-së nuk ka ndjekur ndonjë proces adekuat për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të AP-së. Pyetësi i vetëvlerësimit, i plotësuar nga SHSKUK, ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. SHSKUK ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të vlerësimit dhe menaxhimit të rreziqeve. Funksionimi i NJAB - NJAB vazhdon të veprojë me numër të kufizuar të stafit, në raport me madhësinë dhe kompleksitetin e organizatës. Nuk ka pasur ndonjë auditim të veçantë me fokus në qeverisje dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm ishte shumë i ulët. Menaxhimi i të hyrave është përcjellë me disa mangësi, mangësi në menaxhimin e kujdestarive, mbajtja e pozitave kyçe, me ushtrues detyre dhe pagë sekondare. Rekrutime dhe avancime pa procedura konkurruese SHSKUK ka angazhuar 69 vetë me marrëveshje për shërbime të veçanta. Po ashtu, ishin identifikuar 12 raste në QKUK dhe 2 (dy) raste në Spitalin e Mitrovicës, ku stafi i brendshëm është avancuar në pozita me gradë-koeficientë më të lartë, pa procedura të konkurrimit. Ndërsa, sa i përket rekomandimeve mund të vendosim, pasi të përfundojmë diskutimin për këtë pikë.

Basri Sejdiu, paraqiti para deputetëve të gjitha përpjekjet që ka bërë SHSKUK-ja, prej kohës që ka marrë mandatin, për t'i adresuar të gjitha çështjet që ka ngritur auditori i përgjithshëm në raportin e auditimit për SHSKUK-në.

Myzafer Kalanderi, theksoi se menaxhmenti i SHSKUK-së, ka bërë të gjitha përgatitjet sa i përket planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2016. Megjithatë, ka pasur sfida dhe pengesa të cilat kanë ndikuar që të mos adresohen të gjitha rekomandimet.

Faton Topalli, pyeti për një të gjetur në raport të auditimit, sa i përket një projekti kapital, në shumën prej 1.08 milion euro, që sipas auditorit nuk ka pasur respektim të proceduarve të prokurimit. Çka është ndërmarrë ndaj zyrtarëve që nuk kanë respektuar këto procedura? Po ashtu, dobësi në plotësimin e formularëve të vetëvlerësimit. Sipas tij, rolin vendimtar duhet ta këtë KMFP.

Shqipe Pantina, theksoi se nëse i referohemi raportit të auditimit për SHSKUK për vitin 2016, vërejmë qartë se këtu ka pasur telashe të shumta në menaxhimin e parasë publike. Mos funksionalizimi i SISH-it, probleme në pagesën e kujdestarive, menaxhim jo i mirë në procedurat e prokurimit, mbivlerësim i pasurive, evidenca jo të sakta të barnave të pranuar brenda stafit mjekësor, janë dëshmia më e mirë se ka shumë punë për t'u bërë brenda SHSKUK-së.

Andin Hoti, theksoi se SHSKUK, si institucion i ri, duhet të jetë model i organizimit të mirë dhe funksional brenda vetë institucionit. Të gjeturat e raportit tregojnë se ka shumë dobësi. Po ashtu, pyeti se çka mund të ndihmojë KMFP në adresimin e rekomandimeve të dhëna nga auditori, si dhe nga nevoja reale për të ndihmuar këtë institucion rishtas të krijuar, si në staf shtesë, po ashtu edhe në pajisje.

Muharrem Nitaj, theksoi se bazuar në raportin e auditimit për SHSKUK-në dhe të gjeturat e prezantuara në këtë raport, të japin një përshtypje se këtu është duke u bërë një përpjekje për të thënë shumëçka, por asgjë konkrete. Në një fjali të raportit, thuhet se të dhënat e prezantuara në raport paraqesin pasqyrat drejt dhe reale, dhe në vazhdim të fjalisë, thuhet se ne tërheqim vëmendjen se disa të dhëna të prezantuara nuk janë të sakta, për sa i përket pasurisë. Ne të gjithë e dimë se brenda spitaleve tona ka keqpërdorime financiare, dhe KMFP, në këtë rast, duhet të ofrojë informata shtesë lidhur me konstatimet e dhëna nga auditori. Raportuesi, si dhe auditori duhet të japin sqarime përtej asaj që është prezantuar në raport. Raporti i auditorit duhet të japë

sqarime konkrete, jo t'i japë të dhënat e përgjithësuara. Po ashtu, pyeti auditorin për të gjeturën në shumën prej 1 milion euro, e cila është e regjistruar në kategori ekonomike të gabuar dhe në pasqyra financiare del se pasuria është e mbivlerësuar. Çka nënkupton kjo, si ndodh që evidencën për barna e mbani ende në formë manuale?

Avdullah Hoti, shtoi se deputetët duhet të jenë të kujdesshëm në fjalën publike, veçanërisht kualifikimet që po i bëhen raporteve të auditimit. Po ashtu, theksoi se nuk është mirë të thuhet se nëse institucioni ka bërë gabim në regjistrimin e shpenzimeve në kode ekonomike të gabuara, nuk do të thotë se është keqpërdorim i mjeteve. Ne nuk jemi prokurorë dhe përfaqësuesit e institucioneve nuk duhet ta ndjejnë veten se janë në gjykatë. Regjistrimi i një shpenzimi kapital në mallra dhe shërbime nuk nënkupton se këtu ka pasur keqpërdorim të parasë publike. Kjo, po ashtu, nuk është përgjegjësi e Ministrisë së Financave. Ju lutem të keni kujdes në pyetjet e juaja me hamendësi. Pranimi i mallit pa urdhër-blerje, mendoj se është gabim, por jo të tjerat, ose mosmenaxhimi i kontratave mund të klasifikohen si shkelje.

Mërgim Lushtaku, pyeti: pse nuk ka ndarje të duhura të detyrave brenda Spitalit të Vushtrrisë, si dhe menaxhimi i barnave si është duke u bërë tani në SHSKUK, po ashtu pse ka ngecur projekti me Danimarkën?

Faton Topalli, theksoi se shkeljet e cekura në raport janë shkelje në procedura të prokurimit, dhe atë ku ka mosrespektim të procedurave të prokurimit, mund të ketë edhe keqpërdorim të mënyrës së zgjedhjes së operatorëve ekonomikë.

Basri Sejdiu u përgjigj në të gjitha pyetjet e parashtruara nga deputetët.

Shqipe Pantina, theksoi se deputetët mund të bëjnë pyetje dhe komente, për të cilat mendojë se do të ndihmojnë në arritjen e objektivave të vetë institucionit, por në të njëjtën kohë për t'i kuptuar më drejtë të gjeturat e auditorit të jashtëm.

Kryetari njoftoi të pranishmit dhe deputetët se rekomandimet për SHSKUK-në do t'i miratojmë në takimin e radhës së KMFP-së.

Përfundim

KMFP vendosi që raporti i auditimit për PVF-të e SHSKUK-së, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të mos adresohet për seancë plenare, ndërsa rekomandimet do të miratohen mbledhjen e radhës së komisionit.

5. Shqyrtimi i raportit të performancës për efikasitetin dhe efektivitetin në implementimin e Sistemit informativ unik të integruar shëndetësor

Kryetari njoftoi deputetët se ministri i Shëndetësisë, z. Uran Ismajli, për shkak të agjendës nuk do të jetë prezent në këtë takim, andaj pa prezencën e ministrit, nuk mund ta shqyrtojmë raportin.

6. Të ndryshme

Kryetari njoftoi deputetët se Parlamenti Evropian do të organizojë një tryezë në Maqedoni, më datë 26 shkurt 2018, ku ka ftuar dy deputetë të komisionit, nëse jeni të pajtimit, ne kemi vendosur të përfaqësohemi nga unë, në cilësinë e kryetarit dhe Andin Hoti, anëtar i komisionit.

Po ashtu, për takimin e radhës së komisionit do të shqyrtohet raporti i auditimit për MASHT dhe Universitetin, ku raportues do të jetë deputeti Andin Hoti. Gjithashtu, njoftoi se punëtorja për të shqyrtuar Projektligjin për kontrollin e brendshëm financiar, do të mbahet të mërkurën, më datë 14.2.2018, në Vila Gërmi.

Përfundim

KMFP vendosi që punëtorja për Projektligjin për kontrollin e brendshëm financiar të mbahet më 14.2.2018, në Vila Gërmi, me shpenzime të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj